

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë përcakton statusin e magistratëve dhe ndihmës magistratëve, duke parashikuar rregulla për të drejtat dhe detyrimet e tyre, kriteret dhe procedurën për pranimin dhe emërimin e tyre, për zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre, për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të tyre si dhe kriteret dhe procedurën për përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në thelb është një sistem garancish personale në funksion të pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor. Garancitë ligjore për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me mënyrën e emërimit të tyre, të menaxhimit të karrierës, garancitë për qëndrimin në detyrë (patundshmërinë), përveç rasteve dhe situatave të parashikuara qartë në ligj, si dhe me përfitimet financiare dhe jofinanciare gjatë ushtrimit të detyrës dhe pas përfundimit të detyrës.

Ligji parashikon një sistem garantues të drejtash dhe llogaridhënie që synon ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur ndaj çdo influence politike, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Bazuar në Analizën e Sistemit të Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë ka identifikuar probleme që lidhen me të gjitha aspektet e statusit të gjyqtarit dhe prokurorit, duke filluar që nga emërimi, promovimi, vlerësimi, disiplinimi dhe trajtimi i tyre financiar.

Konkretisht, bazuar mbi një analizë të detajuar të kuadrit ligjor në fuqi, për statusin e magistratëve është vërejtur se:

- Dispozitat mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të shpërndara në akte të ndryshme ligjore, nënligjore dhe me natyrë rregullatore. Vërehet se mungon një ligj gjithëpërfshirës që të parashikojë në mënyrë të detajuar dispozitat për statusin e gjyqtarëve, si dhe të institucioneve përgjegjëse dhe procedurave që ndiqen në vendimmarrjet mbi këtë status.

- Parashikimet aktuale lidhur me papajtueshmëritë specifike të funksionit të gjyqtarit dhe ndalimet ndaj tyre për të ushtruar veprimtari të caktuara publike e private janë shumë të përgjithshme. Ligji nuk parashikon shprehimisht, qartë dhe mjaftueshëm rastet që lidhen me veprimtarinë e ndaluara dhe të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit.
- Kriteret dhe procedurat për emërimin si gjyqtar nuk janë parashikuar tërësisht nga ligji në përputhje me kërkesat e objektivitetit, meritokracisë, procesit të rregull ligjor dhe transparencës.
- Krahas nevojës për rritjen e cilësisë së përgatitjes teorike, mungojnë rregullime normative dhe mekanizma institucionalë mbi kriteret dhe procedurat e testimit dhe verifikimit të kandidatëve për t'u pranuar në trajnim fillestar, deri në përfundim të tij për sa u përket cilësive të domosdoshme të përvojës jetësore, inteligjencës dhe pjekurisë së duhur njerëzore, si edhe të cilësive të duhura të personalitetit e të integritetit për t'i shërbyer publikut dhe, posaçërisht, për të ushtruar funksionin kushtetues të gjyqtarit.
- Ka mangësi në legjislacionin dhe mekanizmin institucional lidhur me kriteret dhe procedurat e testimit dhe të verifikimit të domosdoshëm që duhet të zbatohen për pranimin në karrierë gjyqësore dhe emërimin si gjyqtar ose prokuror të atyre që, përjashtimisht, nuk i nënshtrohen trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, si në aspektin e njohurive profesionale, ashtu edhe në drejtim të cilësive të nevojshme të personalitetit e të integritetit për t'i shërbyer publikut dhe posaçërisht për të ushtruar funksionin kushtetues të gjyqtarit.
- Mungon një mekanizëm efektiv, verifikues dhe ankimes ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi emërimet e gjyqtarëve.
- Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë janë shoqëruar në vazhdimësi nga politizime të procesit dhe vonesa në plotësimin e vendeve vakante.
- Praktika ka evidentuar se procesi i konkurrimit për gjyqtarët administrativë nuk ka rezultuar në një sistem eficient dhe stimulues.
- Proces i përzgjedhjes së kandidatëve nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për t'u emëruar në gjykatat e apelit vlerësohet se është bërë jashtë kriterëve objektive.
- Ligji nuk parashikon shprehimisht, qartë dhe mjaftueshëm çështjet që lidhen me kriteret, procedurat dhe kompetencat për vlerësimin profesional të gjyqtarëve. Nga ana tjetër, me ndonjë përjashtim, këto çështje përgjithësisht janë trajtuar me akte nënligjore të nxjerra nga vetë KLD-ja, gjë që nuk kënaq standardin e parashikimit nga ligji të çështjeve që lidhen me statusin e gjyqtarit.
- Ligji nuk parashikon shprehimisht, me rregulla të mjaftueshme dhe të qarta as edhe që vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me vlerësimin profesional të gjyqtarit të jenë subjekt i verifikimit administrativ, si edhe të drejtën e gjyqtarit të vlerësuar për të ankimuar edhe në gjykatë vendimin e këtij Këshilli.
- Ligji nuk parashikon procedura të qarta dhe të mjaftueshme, objektive e transparente për krijimin, shpalljen dhe plotësimin e vendeve vakante në gjykata, të cilave KLD-ja duhet t'u përmbahet në procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata *nëpërmjet transferimit* të gjyqtarëve të interesuar nga gjykatat e tjera të të njëjtin nivel.
- Transferimi i përhershëm i gjyqtarëve duket më problematik teksa ai shpesh ngatërrohet me promovimin. Kuadri ligjor nuk është i qartë në lidhje me kompetencat ndërmjet MD-së dhe KLD-së për transferimin e procedurat standarde për përcaktimin e numrit optimal të gjyqtarëve për çdo gjykatë.
- Ligji nuk parashikon rregullime të mjaftueshme lidhur me kompetencën, rastet dhe kriteret mbi të cilat vlerësohet dhe vendoset për *delegimin e gjyqtarëve* për shqyrtimin e çështjeve të caktuara për një kohë të caktuar në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë rregullisht detyrën.

Ligji nuk i parashikon afatet maksimale të delegimit dhe rastin e delegimit për caktimin e përkohshëm të gjyqtarit në funksione drejtuese.

- Po kështu, ligji nuk parashikon shprehimisht se delegimi nuk mund të vendoset pa pëlqimin e gjyqtarit. Deri më sot KLD-ja nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur këtij aspekti të parimit të palëvizshmërisë së gjyqtarit nga detyra, i cili duhet të respektohet.

- Ligji nuk parashikon kompetenca dhe procedura të qarta dhe të mjaftueshme, objektive e transparente për rastet kur *transferimi i gjyqtarëve* duhet të bëhet edhe *pa pëlqimin e tij* për rrethana të lidhura me riorganizimin e gjykatave, sipas ligjit dhe në funksion të garantimit të shërbimit gjyqësor në territor dhe në lëndë gjyqësore.

- Ligji nuk parashikon shprehimisht, me rregulla të mjaftueshme dhe të qarta, se ngritja në detyrë (promovimi) ka të bëjë vetëm me rastet e “transferimit” të gjyqtarit nga detyra aktuale e tij në një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, në një gjykatë të fushës së veçantë të të njëjtit nivel, si dhe me rastet e caktimit të tyre në funksionet drejtuese të gjykatave.

- Deri më sot, vendimet e KLD-së lidhur me ngritjen në detyrë të gjyqtarëve nuk janë as subjekt i verifikimit të brendshëm administrativ dhe as i ankimit ndaj tyre në rrugë gjyqësore nga gjyqtarët e interesuar, ndonëse në komunitetin e gjyqtarëve janë shfaqur në vazhdimësi pakënaqësi për këto çështje.

- Vërehet mbivendosje dhe paqartësi e konsiderueshme ndërmjet kompetencave të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ministrit të Drejtësisë në lidhje me inspektimet e gjykatave, rishikimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve.

- Ligji aktual “Për pushtetin gjyqësor” përmban një klasifikim e renditje të pazakontë dhe konfuzë të shkeljeve disiplinore, të cilat rezultojnë se nuk i përgjigjen dhe nuk i ndihmojnë synimit të parashikimit të përshkallëzuar, ezaurues e të qartë të shkeljeve disiplinore sipas llojit dhe rëndësisë së tyre.

- Praktika e KLD-së në zbatimin e masave disiplinore ka treguar se kufijtë ndërmjet shkeljeve të ndryshme disiplinore të parashikuara nga ligji nuk janë gjithmonë të qartë. Po kështu, duket se gama e sanksioneve disiplinore është relativisht e vogël dhe, si e tillë, nuk lejon gjithmonë përcaktimin e sanksioneve proporcionale.

- Ligji nuk bën dallimin dhe klasifikim e nevojshëm ndërmjet shkeljeve disiplinore që kryen gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor, jashtë funksionit gjyqësor dhe atyre që pasojnë/shoqërojnë kryerjen e veprës penale nga gjyqtari. Afati 5-vjeçar i parashkrimit nga dita e kryerjes së shkeljes është tepër i gjatë.

- Hetimi disiplinor është pjesërisht nën ombrellën e ekzekutivit dhe pjesërisht në kompetencën e Inspektoratit të KLD-së, i cili ushtron funksionin e tij nën mbikëqyrjen e nënkryetarit të KLD-së. Rregullat procedurale janë të dobëta dhe nuk janë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

- Një nga çështjet e konsideruara problematike është mospërfshirja e anëtarëve të GjL-së nën juridiksionin e KLD-së për sa u përket çështjeve të procesit disiplinor. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë janë subjekt i procedimit disiplinor vetëm për shkelje ekstreme, për të cilat gjen zbatim vetëm masa disiplinore ekstreme e shkarkimit nga detyra.

- Ligji nuk parashikon shprehimisht, qartë dhe mjaftueshëm çështjet që lidhen me rastet e mbarimit të karrierës gjyqësore, si çështje thelbësore të lidhura me parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarit nga detyra. Ligji nuk parashikon veprimet dhe procedurat që duhet të ndiqen në raste të caktuara të mbarimit të mandatit të gjyqtarit.

- Sistemi i pagave, shpërblimeve dhe kujdesit social e shëndetësor të gjyqtarëve, si një nga mjetet për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së tyre në detyrë, nuk i përgjigjet domosdoshmërisë së trajtimit financiar adekuat dhe dinjitoz të tyre.
- Paga dhe trajtimi financiar aktual i gjyqtarit nuk mban parasysh në masë të mjaftueshme dinjitetin e detyrës e të profesionit, natyrën e përgjegjësive të funksionit gjyqësor, shkallën e vështirësive në përmbushjen e tij, numrin e lartë të papajtueshmërive dhe ndalimeve të posaçme për të kryer veprimtari të tjera që sjellin të ardhura, nevojën për t'i mbrojtur nga presionet dhe ndikimet në veprimtarinë e tyre gjyqësore e në sjelljen e tyre në tërësi, si edhe nevojat e integritetit social të tij dhe të familjes në shoqëri.
- Pavarësisht përmirësimeve të vazhdueshme, sistemi i kujdesit social nuk garanton që paga e gjyqtarit në kohën e pensionit të plotë të tij jetë sa më e përafërt me atë që përfitonte në mbarim të mandatit.
- Legjislacioni nuk parashikon konkretisht lehtësira dhe përfitime të posaçme financiare për gjyqtarin dhe familjen e tij për sa i përket kujdesit shëndetësor. Legjislacioni nuk parashikon forma të tjera shpërblimi dhe kompensimi efektive për gjyqtarët që caktohen të ushtrojnë detyrën jashtë vendbanimit të tyre.
- Ligji, me parashikimet aktuale të tij, nuk ofron kushte, mënyra dhe mjete efektive që të garantojnë sigurinë e gjykatave dhe sigurinë e gjyqtarëve, me qëllim mbrojtjen nga shteti të jetës dhe pasurisë së tyre dhe të familjes kundrejt presioneve, kërcënimeve dhe akteve të dhunës që mund të vijnë për shkak të ushtrimit të detyrës, në ambientet e gjykatës dhe jashtë saj.
- Ligji për pushtetin gjyqësor nuk parashikon shprehimisht kushtet e posaçme të ushtrimit të së drejtës së gjyqtarit për të kërkuar shkëputje dhe leje të pagueshme për motive të ndjekjes së programeve të profilizimit profesional brenda dhe jashtë vendit, për përgatitjen dhe mbrojtjen e gradave shkencore, si edhe të lejeve të pa pagueshme për motive të caktuara.

Ndërkohë që për statusin e prokurorëve, nga analiza e kryer, u vu re se:

- Praktika aktuale ka treguar se emërimet, në veçanti ato jashtë Shkollës së Magjistraturës, si dhe vendimet lidhur me prokurorët e karrierës nuk janë udhëhequr gjithmonë nga kriteret objektive dhe procedura transparente. Vendimet e transferimit të prokurorëve nuk janë të bazuara në kriteret të mirë -përcaktuara.
- Vlerësimi paraprak i punës së prokurorit kryhet nga drejtuesi i prokurorisë. Nuk ka një procedurë të standardizuar vlerësimi, të shoqëruar me kriteret specifike për matjen e aftësive, kompetencës dhe integritetit. Gjithashtu, nuk ofrohet mundësia për të apeluar rezultatet e vlerësimit ose vendimin e emërimit.
- Emërimi i drejtuesve të prokurorive mund të kryhen nga Prokurori i Përgjithshëm, në bazë të kriterëve të përgjithshme dhe gjithashtu shkarkimin e tyre në bazë të – mos përmbushjes së detyrave funksionale, pavarësisht rëndësisë së tyre dhe nuk parashikon mundësinë e apelimit kundër vendimit përkatës të shkarkimit.
- Mungojnë kriteret objektive dhe procedurat transparente në lidhje me vendimin e emërimit, karrierës, promovimit dhe disiplinimit të prokurorëve. Gjithashtu, përbën shqetësim mungesa e llogaridhënies së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
- Ligji nuk parashikon mekanizma kontrolli dhe llogaridhënie për Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me veprimtarinë e tij.
- Mungojnë mekanizmat efikas të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, për të shmangur ndërhyrjen e papërshtatshme në veprimtarinë e prokurorisë.

Bazuar në problematikat e evidentuara dhe të analizuara në Dokumentin e Analizës së Sistemit të Drejtësisë, ky projektligj parashikohet të ketë këto përparësi dhe efekte të pritshme:

- Qartëson, përmirëson, konsolidon dhe përmbledh në një ligj të vetëm duke kodifikuar dispozitat e shpërndara që lidhen me statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.
- Garanton një proces emërimi dhe promovimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të bazuar në kritere transparente, objektive dhe meritokratike të tilla si: kualifikimet, integriteti, aftësitë profesionale dhe pastërtia që do të rezultojë nga procesi i vlerësimit dhe rivlerësimit.
- Rikoncepton sistemin e trajnimit vazhdues dhe të vlerësimit periodik të gjyqtarëve dhe prokurorëve për efekt karriere, duke zgjeruar e forcuar më tej kriteret objektive për matjen e aftësisë profesionale, si dhe duke konceptuar e zbatuar kritere dhe teste për matjen e integritetit moral e psikologjik të tyre.
- Përfshin edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë në skemën e vlerësimit dhe të përgjegjësisë disiplinore.
- Qartëson dhe detajon të gjitha shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe sanksionet proporcionale në përputhje me shkeljet, duke e orientuar sistemin e përgjegjësisë disiplinore mbi kritere sa më objektive.
- Procedimi disiplinor rikonceptohet si një sistem garantues ku janë të ndara përgjegjësitë e institucioneve që kryejnë hetimin, institucioneve që marrin vendimin dhe institucioneve që shqyrtojnë ankimin e ushtruar ndaj vendimeve për masat disiplinore, duke i garantuar magjistratit në të gjitha hallkat e kësaj procedure, të drejtën për një proces të rregullt.
- Përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që sigurojnë përzgjedhjen e kandidatëve për magjistratë (gjyqtarë dhe prokurorë) dhe konfirmimin e tyre në karrierë, duke u bazuar në kritere objektive e transparente.
- Përkufizon në mënyrë të qartë dhe të plotë të të drejtave, detyrimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe papajtueshmërive me ushtrimin e funksionit në ligjin e posaçëm për statusin e magjistratit .
- Përmirëson në mënyrë rrënjësore trajtimin financiar dhe masat mbështetëse për gjyqtarët dhe prokurorët dhe familjet e tyre, si dhe vendos garancitë për trajtim financiar të gjyqtarëve dhe familjeve të tyre edhe pas lënies së detyrës.
- Ofron garancitë e nevojshme për ata magjistratët dhe ndihmës magjistratët të cilët janë në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe që kalojnë me sukses procesin e vlerësimit të pasurisë dhe të figurës dhe rivlerësimit.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me ndryshimet kushtetuese të miratuara nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë dhe legjislacionin vendas. Një komponent shumë i rëndësishëm i procesit të draftimit të këtij ligji ka qënë referimi dhe huazimi i standarteve ndërkombëtare dhe praktikave ligjore më të mira të vendeve të zhvilluara. Adoptimi i këtyre standarteve është një garanci për përmbushjen e aspiratave integrale të vendit drejt familjes evropiane.

Sinkronizimi i këtij ligji me këto standarte e praktika, duke i përshtatur ato në përputhje me kontekstin e zhvillimeve në vendin tonë, është një fillim i mbarë drejt ngritjes së një sistemi gjyqësor të përafuar dhe të ngjashëm me ato sisteme që i përkasin vendeve me demokraci të konsoliduar.

Në ligj përcaktohen qartë dhe në mënyrë të plotë **parimet të cilat udhëheqin ushtrimin e funksionit¹, të drejtat, detyrimet e magjistratëve si dhe papajtueshmëritë me ushtrimin e detyrës**. Parimisht magjistratët janë të lirë të angazhohen në veprimtari të tjera, përtej funksionit të tyre. Dokumentat ndërkombëtare rekomandojnë që të gjendet një ekuilibër i arsyeshëm midis aktiviteteve përtej funksionit dhe parimit të paanshmërisë.² Përsa më sipër, ligji parashikon si të papajtueshëm me funksionin e magjistratit angazhimin në veprimtari politike, si dhe parashikon kritere që duhet të përmbushë një aktivitet më qëllim që të jetë i lejueshëm.

Projektligji për Statusin parashikon gjithashtu përmirësim rrënjësor të **trajtimit financiar dhe të masave mbështetëse** gjatë dhe pas lënies së detyrës, duke u mbështetur në parimin se niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që ti mbrojtë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.³ Duke u mbështetur në Kartën Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve⁴, ligji parashikon që magjistratët të përfitojnë nga sigurimet shoqërore, me fjalë të tjera mbrojtje kundër rreziqeve të zakonshme sociale, të tilla si sëmundje, barrëindje, invaliditet, pleqëri dhe vdekje. Gjithashtu, Projektligji reflekton standartet e Kartës Evropiane, sipas së cilës, niveli i shpërblimit të një gjyqtari në krahasim me një tjetër mund të jetë subjekt i faktorëve të tillë si kohëzgjatja e shërbimit, natyra dhe rëndësia e detyrave, vështirësia e tyre, etj.⁵

Në disa vende, **proçesi i rekrutimi dhe emërimit** të magjistratëve bazohet në rezultatet e arritura nga një proces konkurrues, ndërsa në vende të tjera ky proces kryhet nëpërmjet përzgjedhjes nga radhët e praktikantëve me përvojë të ligjit. Ligji synon të kombinojë të dyja këto sisteme rekrutimi.

Duke qënë se standartet ndërkombëtare rekomandojnë se personat që janë përgjegjës për trajnimin nuk duhet të jetë drejtpërdrejtë përgjegjës për emërimin ose promovimin e gjyqtarëve⁶, ligji parashikon se **trajnimi** dhe konkursi është një detyrë që i takon Shkollës së Magjistraturës, ndërsa emërimi i magjistratëve i takon Këshillit të Lartë Gjyqësor. **Proçesi i pranimit në Shkollën e Magjistraturës** si dhe emërimi do të bazohet në kritere transparente, objektive dhe meritokratike të tilla si: kualifikimet, integriteti, aftësitë profesionale dhe pastërtia e gjendjes gjyqësore (mungesa e precedentëve penalë), verifikimi i pasurisë dhe figurës (vetting).

Bazuar në Opinionin e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, nr. 17 (2014) "Mbi Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve, Cilësinë e Drejtësisë, dhe Respektin për Pavarësinë e Gjyqësorit", në projektligj parashikohet një sistem promovimi për magjistratët, bazuar në kritere

¹ Rekomandimi CM/Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave.

² Opinion nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) (2002), mbi rregullat dhe parimet që normojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, paanshmërinë dhe papajtueshmërinë me detyrën.

³ Rekomandimi (2010) 12 i Komisionit të Ministrave.

⁴ Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve, 8-10 Korrik 1998.

⁵ Po aty, par. 6.2.

⁶ Opinioni nr. 4 i CCJE, mbi trajnimin e duhur fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve në nivel kombëtar dhe Europian.

objektive të tilla si aftësitë profesionale, integriteti dhe përvoja e punës. Sikurse standartet ndërkombëtare rekomandojnë⁷, ligji parashikon se kur magjistratët aplikojnë për promovim, ata duhet që ti nënshtrohen një **skeme vlerësimi**, e cila përveç të tjerave parashikon verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatëve.

Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë thekson nevojën e reduktimit të disa detyrave të papërshtatshme që kryhen nga gjyqtarët. Këto detyra, të cilat konsistojnë në aktivitete të tilla si punë kërkimore, hartimi i dokumenteve ligjorë, etj, mund t'i delegohen ndihmësve ligjorë të cilët janë nën përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen e këtyre gjyqtarëve.⁸ Për të siguruar një përgatitje të mirë dhe një status të duhur të ndihmësve ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese dhe për ti bërë këto pozicione sa më tërheqëse për magjistratët e sapodiplomuar, ligji ka parashikuar për ndihmësit ligjorë statusin e magistratit. Kjo do të thotë që ata janë subjekt i rregullave të transferimit, promovimit, vlerësimit dhe disiplinimit të këtij ligji.

Kohëzgjatja e mandatit të magjistratëve është e garantuar me ligj. Ky është një nga parimet bazë që siguron pavarësinë e gjyqësorit. Ashtu sikurse standartet ndërkombëtare rekomandojnë⁹, ligji parashikon një listë ezauruese të rasteve kur përfundon mandati i magistratit, të tilla si dorëheqja, mbarimi i mandatit për shkak të ligjit, dalja në pension, largimi nga funksioni për shkaqe disiplinore ose procedim penal, si dhe për arsye të paaftësisë fizike dhe mendore. Të gjitha këto raste janë të mirëpërcaktuara me ligj pasi mungesa e qartësisë së këtyre dispozitave mund të përbëjë shkak për ndikime në ushtrimin e funksionit të magistratit.

Referuar Opinionit nr. 17 të CCJE-së të vitit 2014, ligji përmirëson dukshëm **sistemin e vlerësimit periodik** për magjistratët, duke parashikuar kritere objektive për matjen e aftësisë profesionale të magjistratëve, si dhe duke konceptuar e zbatuar kritere dhe teste për matjen e integritetit moral e psikologjik të tyre.¹⁰ Në linja të përgjithshme, sistemi i vlerësimit ndihmon në përmirësimin e cilësisë së sistemit gjyqësor, duke identifikuar nevojat për trajnim, nevojat për ndryshime organizative në gjyqësor, magjistratët të cilët mund të promovohen, etj. Në këtë mënyrë rritet përgjegjshmëria dhe llogaridhënia e gjyqësorit ndaj qytetarëve. Sistemi i ri i vlerësimit fokusohet në vetëvlerësimin e magistratit duke i dhënë atij rol aktiv në këtë proces dhe e bërë atë partner në këtë mekanizëm. Ky vetëvlerësim pasohet më tej me vlerësimin e kryetarit të gjykatës apo prokurorisë ku ai ushtron funksionet e tij.

Bazuar në standartet ndërkombëtare, projektligji përcakton në mënyrë të qartë dhe objektive dispozitat materiale dhe procedurale lidhur me **procedimin disiplinor** ndaj magjistratëve. Standartet ndërkombëtare rekomandojnë që parashikimet normative të mos lenë hapësirë për paqartësi ose dykuptueshmëri, pasi në të kundërtën masat disiplinore nuk i shërbejnë qëllimit të tyre në funksion të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve, por mund të përdoren në mënyrë abuzive si një mjet për të cënuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.¹¹ Kështu,

⁷ Opinioni i CCJE nr. 17 (2014), Mbi Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve, Cilësinë e Drejtësisë, dhe Respektin për Pavarësinë e Gjyqësorit, par. 27.

⁸ Opinioni i CCJE nr. 6 (2004), Mbi Proçesin e Rregullt Ligjor Brenda një Afati të Arsyeshëm dhe Roli i Gjyqtarit në Gjykatë lidhur me Metodën Alternative të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, par. 65.

⁹ Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve, Strasburg 8 - 10 Korrik 1998, par. 7.1.

¹⁰ Opinioni i CCJE nr. 17 (2014), Mbi Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve, Cilësinë e Drejtësisë, dhe Respektin për Pavarësinë e Gjyqësorit.

¹¹ Raport i ENCJ, Zhvillimi i Standarteve Minimale Gjyqësore, Hagë 5 Qershor 2015, par. 3, fq. 17.

sikurse CCJE rekomandon, projektligji liston të gjitha ato veprime/mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore, si dhe garanton elementët e procesit të rregullt ligjor për shqyrtimin e këtyre shkeljeve, vendosjen e sanksioneve proporcionale në përputhje me shkeljen e kryer, si dhe të drejtën e ankimit në një organ tjetër më të lartë e të pavarur.¹²

VI. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me *acquis communautaire*.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt ligji për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve përbëhet nga 6 tituj, të ndarë në krerë dhe seksione, ku janë shpërndarë 182 nene.

Në Titullin I, parashikohen Dispozitat e Përgjithshme të projektligjit, ku përcaktohet objekti dhe përkufizimet e termave të përdorura në projektligj. Termi i magjistratit është ndër më të përdorurit në tekst, i cili i referohet, gjyqtarëve dhe prokurorëve, me përjashtim të gjyqtarëve të gjykatës Kushtetuese. Referimi që projektligji bën tek magjistratët përfshin edhe ndihmës magjistratët, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe. Gjithashtu, në listën e këtyre termave përkufizohet transferimi, ngritja në detyrë dhe komandimi i magjistratëve, si koncepte të cilat në kuadrin ligjor aktual janë konsideruar të paqarta dhe konfuze.

Në Titullin II, parashikohen të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve. Ky Titull përbëhet nga 5 krerë, të cilët parashikojnë vlerat themelore dhe të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme (Kreu I); papajtueshmëritë, kufizimet dhe veprimtaritë e tjera (Kreu II); Pagën dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore (Kreu III); lejen dhe uljen e kohës së punës (Kreu IV); të drejtat e tjera (Kreu V).

Ndër vlerat themelore gjyqësore dhe prokuroriale që parashikohen në këtë ligj lidhet me ushtrimin e funksionit të magjistratit, duke i nënshtuar vetëm Kushtetutës dhe ligjit, si dhe ushtrimi i këtij funksioni në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i tërthortë. Projektligji parashikon se magjistrati është i lirë nga lidhjet dhe ndikimi i papërshtatshëm i pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, por duhet të duket dhe si i tillë në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut, profesionit ligjor dhe palëve në proces. Projektligji parashikon gjithashtu se, magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, të përpiktë dhe në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, përmbajtje dhe maturi.

¹² Opinion nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (ÇJE) (2002), mbi rregullat dhe parimet që normojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, paanshmërinë dhe papajtueshmërinë me detyrën, par. 74.

Dispozitat e këtij titulli parashikojnë të drejtat dhe detyrimet e magjistratit për të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues, për të propozuar kurse trajnimi dhe për të bashkëpunuar përkatësisht me Këshillin e Lartë Gjyqësor ose të Prokurorisë, me qëllim për të përmirësuar programet e trajnimit. Gjithashtu, projektligji parashikon detyrimin e magjistratit për tu përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës si dhe përcakton kohëzgjatjen minimaliste, gjatë të cilës magjistrati duhet të marrë pjesë në formimin vazhdues.

Në projektligj, parashikohen rastet specifike dhe bëhet i qartë dallimi mes papajtueshmërive, kufizimeve për shkak të funksionit, papajtueshmëritë ambientale dhe veprimtaritë që lejohen të kryhen jashtë funksionit. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike si dhe kryerjen e çdo veprimtarie politike që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i paragjykuar.

Në mënyrë të veçantë, projektligji parashikon për herë të parë papajtueshmëritë ambientale të magjistratëve, të cilat konsistojnë në vendosjen e disa kufizimeve të kushtëzuara, për të ushtruar funksionin në gjykata ose prokurori për shkak të marrëdhënieve familjare midis magjistratëve.

Projektligji parashikon një skemë stimuluese dhe favorizuese, për trajtimin financiar për magjistratët, në përputhje me dinjitetin e detyrës dhe e përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre. Paga e magjistratit caktohet në bazë të kriterëve që kanë të bëjnë me shkallën e gjykatës ose prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin, vjetërsinë në ushtrimin e funksionit dhe fushën e veçantë të kompetencës lëndore në të cilën magjistrati ushtron funksionin. Përfitimet e tjera financiare caktohen duke u bazuar në vjetërsinë e ushtrimit të funksionit, ushtrimin e funksioneve drejtuese, transferimin e përkohshëm, arritjet lidhur me natyrën dhe volumin e çështjeve të trajtuara, arritjet e tjera etiko-profesionale, kushtet e veçanta të punës, gjendjen personale dhe atë familjare të magjistratit. Magjistrati gëzon të drejtën për të patur si pjesë e pagës edhe sigurimin e detyrueshëm të jetës, shëndetit dhe pronës për shkaqe të lidhura me ushtrimin e funksionit, sëmundjet, aksidentet, veprimtaritë njerëzore dhe fenomenet natyrore. Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen, me përjashtim të rasteve kur ka krizë ekonomike ose emergjenca kombëtare, kur magjistrati ushtron të drejtën për t'u kthyer, kur pozicioni i mëparshëm ishte më i lartë ose më i specializuar me mandat të kufizuar dhe pagesë më të lartë, kur ndaj tij/saj jepet masë disiplinore ose kur ka nivel të ulët vlerësimi profesional dhe etik sipas parashikimeve të këtij ligji.

Gjithashtu, në këtë titull parashikohet ndër të tjerash si risi e drejta e magjistratit për të përfituruar ulje të ngarkesës së çështjeve, në rastet e sëmundjeve të përkohshme, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në 2 vjet ose në rastet e ndjekjes së studimeve jashtë kursit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në tre vjet.

Në Titullin III, parashikohen dispozita lidhur me zhvillimin e karrierës së magjistratëve. Ky titull përbëhet nga 8 krerë, të cilët parashikojnë procedurat dhe kriteret për rekrutimin e kandidatëve magjistratë (Kreu I), procedurat dhe kriteret e emërimit të magjistratëve (Kreu II), procedurat dhe kriteret për caktimin e magjistratëve në pozicion (Kreu III), procedurat dhe

kriteret e transferimit, ngritjes në detyrë, komandimit dhe mandatit të kufizuar (Krerët IV, V, VI dhe VII), si dhe mbarimin e mandatit (Kreu VIII).

Kreu I i këtij titulli parashikon procedurat dhe afatet për aplikimin për formimin fillestar, aplikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, organizimin dhe kryerjen e provimit, verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve që kanë marrë rezultate të larta nga provimi, kryerja e stazhit profesional nga kandidatët për magistratë gjatë vitit të tretë të formimit fillestar, renditjen e të diplomuarve në listë, bazuar në rezultatet e provimit përfundimtar si dhe vlerësimet gjatë stazhit.

Lidhur me kriteret për të aplikuar në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magistrat, parashikohet si risi që kandidatët duhet të kenë të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në Fakultetin e Drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlefshëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare. Gjithashtu, parashikohen si kriter ndaluese (skualifikuese) qenia anëtar i partive politike në kohën e aplikimit, qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i shtetit përpara vitit 1990 si dhe qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i asnjë shërbimi sekret.

Projektligji parashikon se i diplomuari emërohet magistrat nëse është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në programin e formimit fillestar, me të paktën 70% të pikëve; është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit, si pjesë e formimit fillestar; si dhe ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat. Parashikohet si risi në këtë projektligj, emërimi i ish gjyqtarëve dhe ish prokurorëve si magistrat, të cilët mund të kandidojnë për tu riemëruar brenda dy javëve nga data e publikimit të listës së të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, nëse përmbushin një pjesë të kriterëve që duhet të kenë personat që aplikojnë në këtë Shkollë, nëse kanë ushtruar funksionin e magistratit të paktën 5 vjet në 10 vitet e fundit dhe nuk kanë qënë anëtar të partive politike ose të Kuvendit të Shqipërisë, nuk kanë mbajtur një pozicion politik në administratën publike, ose në një parti politike, ose funksione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kërkesës për riemërim si magistrat.

Në ndryshim nga kuadri ligjor ekzistues, ky ligj rregullon në mënyrë të detajuar caktimin e magistratëve në pozicionet e lira, mbas diplomimit dhe emërimit të tyre si magistrat. Caktimi në pozicione të emëruarve të sapodiplomuar në Shkollën e Magjistraturës, vlerësohet prioritar dhe bazohet në renditjen e tyre në listën e të diplomuarve dhe përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit, për aq sa është e mundur. Magistrati që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në administratën publike, të paktën gjysmën e përvojës së kërkuar para se të pranohej në formimin fillestar ose të ketë rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative, në Shkollën e Magjistraturës.

Në rastet kur numri i kërkesave për t'u caktuar në pozicion është më i madh se numri i vendeve të lira për magistrat, Këshillat (Gjyqësor ose i Prokurorisë) marrin masa për komandimin e të emëruarve në pozicione të tjera në sistemin e drejtësisë, duke i ofruar atyre, mundësinë e zgjedhjes për të paktën dy pozicione. I emëruari i komanduar në shërbime të tjera, duhet të marrë pjesë në procedurën e ardhshme të transferimit paralel, me qëllim që të caktohet në pozicione të

lira në një afat sa më të shpejtë. I emëruari i komanduar në pozicione të tjera përfiton pagë dhe përfitime të tjera financiare të barabarta me ato që përfitojnë magjistratët e shkallës së parë.

Magjistrati nuk transferohet pa pëlqimin e tij/saj, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në projektligj. Gjithashtu, magjistrati nuk transferohet pa pëlqim në gjykata të një shkalle më të ulët se gjykata në të cilën magjistrati ushtron funksionet. Magjistrati gëzon të drejtën të marr pagën më të lartë, gjatë periudhës së transferimit. Projektligji nuk lejon transferimin e përkohshëm ose të përhershëm të gjyqtarëve të Gjykatës së antikorruptionit dhe krimit të organizuar. Pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën e Apelit administrativ nuk do të plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjeve paralele, por me procedurën e ngritjes në detyrë. Projektligji parashikon në mënyrë shteruese rastet përjashtimore të transferimit të magjistratëve pa pëlqimin e tyre, për shkaqe disiplinore, për shkaqe që lidhen me suprimimin e pozicionit të magjistratit si rezultat i ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, bazuar në kritere objektive dhe transparente, për shkak të krijimit të marrëdhënieve familjare që çojnë në papajtueshmëri ambientale ose për shkak të mungesave të përkohshme të magjistratëve në gjykata dhe prokurori.

Për ngritjen në detyrë, ligji përcakton kritere objektive profesionale dhe merite si dhe procedura të qarta dhe të unifikuara duke vendosur kritere minimale për përvojën profesionale të magjistratëve të cilët kërkojnë të promovohen në Gjykatat ose Prokuroritë e karrierës. Sipas projektligjit, vlerësohen si pozicione karriere vendet në prokurorinë dhe gjykatat kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, prokuroritë dhe gjykatat e shkallës së dytë, pozicionet për kryetar gjykate ose prokurorie. Gjithashtu, Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicione pranë Gjykatës së Lartë, dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, duke përfshirë edhe përvojën si ndihmës magjistrat ose si magjistrat i komanduar. Risi në këtë projektligj është pikërisht dhënia e mundësive magjistratëve në shkallë më të ulët që të aplikojë për procedurën e lëvizjes paralele në një shkallë më të lartë, duke patur përparësi vetëm në rast se ka të paktën dy vlerësimet etike dhe profesionale renditjen më të lartë.

Delegimi i magjistratëve në pozicione të tjera të sistemit të drejtësisë bëhet me pëlqimin e tyre, me përjashtim të rasteve të caktimit në pozicion të të sapoemëruarve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, magjistrati i deleguar ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si çdo magjistrat tjetër të përcaktuar në këtë projektligj si dhe komandohet jo më shumë se 5 vjet, Projektligji parashikon të drejtën e kthimit të magjistratit në pozicionin e mëparshëm, duke përcaktuar gjithashtu se në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë ose si Prokuror i Përgjithshëm ose në raste të tjera ku ligji parashikon të drejtën për 'tu caktuar në një pozicion në shkallë apeli, magjistrati ka të drejtën për tu caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, të të njëjtës shkallë në rast se plotëson kriteret për atë pozicion.

Në këtë projektligj, risi pas përshtatjes së tekstit me Amendimet kushtetuese, ishte dhe shpallja e pozicioneve të lira në Gjykatën e lartë dhe përcaktimi i kriterëve minimum për kandidatët jashtë sistemit. Zgjedhja dhe mbarimi i mandatit të Kryetarit të gjykatës ose prokurorisë është parashikuar në këtë projektligj, të cilët zgjidhen për një periudhë 3 vjet me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, me përjashtim të Kryetarëve të strukturave të posaçme që zgjidhen vetëm një herë.

Magjistrati largohet nga funksioni në rastet kur jep dorëheqjen, i mbaron mandati për shkak të ligjit; del në pension sipas ligjit, shkarkohet nga funksioni për shkaqe disiplinore, shkarkohet nga funksioni për shkaqe të paaftësisë fizike dhe mendore. Për të gjitha rastet e largimit të magjistratit nga funksioni, projektligji parashikon kriteret përkatëse.

Në Titullin IV, parashikohen dispozitat për vlerësimin e veprimtarisë së magjistratëve. Ky titull përbëhet nga 4 krerë të cilët parashikojnë parimet e përgjithshme të vlerësimit (Kreu I), kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit (Kreu II), vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit (Kreu III) dhe procedurën e vlerësimit (Kreu IV).

Sistemi i vlerësimit ka ndër të tjerash si qëllim të përmirësues në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë profesionale dhe etike të magjistratëve dhe të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së magjistratëve. Rezultatet e vlerësimit orientojnë Këshillat (Gjyqësor dhe të Prokurorisë) lidhur me vendimet për statusin e magjistratit, në funksion të zhvillimit të karrierës bazuar mbi meritat si dhe orientojnë Këshillat dhe Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnim të magjistratëve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre. Sistemi i vlerësimit bazohet dhe zbatohet nëpërmjet parimit të pavarësisë, parimit të meritokracisë dhe zhvillimit të karrierës, parimit të efikasitetit, procesit të rregullt ligjor dhe konfidencialitetit.

Të gjithë magjistratët, përfshirë kryetarët e gjykatave dhe prokurorive, janë subjekt i vlerësimit të veprimtarisë së tyre etike dhe profesionale në përputhje me këtë projektligj. Kryetarët vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar gjykate apo prokurorie. Magjistratët, të cilët janë në skemën e delegimit, ose janë komanduar në Këshilla, Gjykatën e Lartë vlerësohen sipas parashikimeve të këtij ligji. Magjistratët, të cilët janë komanduar në struktura të tjera dhe ruajnë statusin e magjistratit, vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit në strukturën ku janë komanduar. Kriteret mbi të cilat kryhet vlerësimi i magjistratëve janë: Aftësitë gjyqësore ose prokuroriale; Aftësitë organizative; Etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore dhe prokuroriale; Aftësitë njerëzore dhe angazhimit profesional. Projektligji përcakton në mënyrë të detajuar komponentët e të katër kriterëve mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi.

Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës gjyqtar ose gjyqtar i komanduar. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat. Kryetari vlerësohet të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit si kryetar. Procedura e vlerësimit të magjistratit shtrihet në tri faza që konsistojnë fillimisht me kryerjen e vetëvlerësimit nga vetë magjistrati, dhënien e opinionit nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë për magjistratin që ka kryer vetëvlerësimin dhe më pas vlerësimin e magjistratit nga Këshilli. Gjatë procedurës së vlerësimit të magjistratit në Këshill, ai/ajo ka të drejtë të aksesojë dosjen e vlerësimit, të paraqesë prova, të dëgjohet dhe të kundërshtojë projektraportin e vlerësimit.

Në Titullin V, parashikohen dispozita lidhur me përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile, të magjistratëve. Ky titull përbëhet nga 6 krerë, të cilët parashikojnë dispozita të përgjithshme (Kreu I), procedurën e hetimit të shkeljeve disiplinore (Kreu II), fillimin e procedimit disiplinor

(Kreu III), ekzekutimin e vendimeve disiplinore dhe regjistri i tyre (Kreu IV), pezullimin (Kreu V), detyrimet penale dhe civile (Kreu VI).

Procedimi disiplinor udhëhiqet nga parimi i procesit të rregullt, parimi i ligjshmërisë, parimi i inicimit të një procesi nga çdo institucion shtetëror ose nëpunës, parimi i barazisë para ligjit, parimi i prezumimit të pafajësisë dhe vlerësimit të dyshimit, parimi in *dubio pro reo*, parimi i proporcionalitetit, parimi i pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratëve, parimi për drejtësi të hapur, parimi i konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private. Projektligji përcakton në mënyrë të detajuar rastet e shkeljeve disiplinore të cilat kategorizohen në shkelje disiplinore në ushtrim të funksionit, jashtë funksionit të magjistratit dhe shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale.

Këshillat mund të vendos një nga këto masa disiplinore: vërejtje me shkrim; vërejtje publike; ulje e përkohshme e pagës; ulje në detyrë nga një gjykatë me e lartë në një gjykatë më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën ose prokurorinë e Antikorrupsionit dhe krim të organizuar në një gjykatë të juridiksionit të zakonshëm ose në një prokurori tjetër; pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 2 vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale sipas VKM; shkarkim nga detyra. Për secilën nga këto masa disiplinore, projektligji përcakton në mënyrë të qartë kriteret dhe shkeljet disiplinore për të cilat jepen.

Hetimi i shkeljeve disiplinore të magjistratëve kryhet nga Inspektori i Lartë, i cili fillon hetimin me nismë të ankuesit ose kryesisht, bazuar në shkaqe faktike që rezultojnë nga burime të besueshme, sipas të cilave lind dyshim i arsyeshëm se magjistrati është përfshirë në kryerjen e shkeljes. Procedura hetimore përcaktohet në mënyrë të qartë dhe të plotë në projektligj, duke parashikuar afatet e parashkrimit të hetimit të shkeljes disiplinore, afatet e procedimit të shkeljes në Zyrën e Inspektorit të Lartë, procedurën e paraqitjes së ankesave pranë këtij Inspektorati, kriteret për pranueshmërinë e ankesës, shqyrtimi fillestar, vlerësimi dhe verifikimi i ankesës, vendimi që Inspektorati merr për fillimin e hetimit bazuar në ankesë ose kryesisht, zgjerimi ose ndryshimi i objektit të hetimit, rastet e pezullimit të hetimit, të drejtat dhe detyrimet e magjistratit gjatë hetimit, ecuria e hetimeve, marrja në pyetje e magjistratit ose e dëshmitarëve, marrja e provave që i shërbejnë hetimit nga institucione të tjera, dokumentimi dhe mbyllja e hetimit, zgjidhja me marrëveshje e shkeljes disiplinore që i atribuohet magjistratit dhe paraqitja e kësaj marrëveshje për shqyrtim të mëtejshëm pranë Këshillit (Gjyqësor ose të Prokurorisë).

Në projektligj, përcaktohet gjithashtu fillimi i procedurës disiplinore që realizohet nga Këshilli përkatës (Gjyqësor ose i Prokurorisë). Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i bindur që ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që një magjistrat ka patur sjellje të papërshtatshme, depoziton pranë Këshillit kërkesën për të filluar procedimin disiplinor së bashku me dosjen hetimore. Magjistrati ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinor gëzon të drejtën për të paraitur parashtrimet me shkrim pranë Këshillit brenda një afati të caktuar, të marrë pjesë në seancë, të thërrasë dëshmitarë, të paraqesë dokumente, të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në favor të mbrojtjes së tij/saj, të përfaqësohet me avokat ose përfaqësues, etj. Pas shqyrtimit të të gjithë fakteve dhe provave, Këshilli mund të rrëzojë kërkesën për procedim disiplinor ose ta pranojë atë duke vendosur një ose më shumë masa disiplinore. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë nga Këshilli për masë disiplinore. Këshillat marrin të gjitha masat e

nevojshme për zbatimin e masave disiplinore dhe janë përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të të gjitha masave që vendosen në procedimin disiplinor.

Në Titullin VI, parashikohen dispozitat përfundimtare dhe kalimtare të projektligjit. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, institucionet përgjegjëse që kanë qënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji për marrjen e vendimeve për statusin e magjistratit, do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji. Projektligji parashikon dispozita kalimtare që mundësojnë vazhdimin e qëndrimit në detyrë të anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Magjistratët në detyrë në Gjykatën e krimeve të rënda të shkallës së parë dhe të Apelit dhe në prokuroritë e ngritura pranë këtyre gjykatave, pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe kimit të organizuar dhe Prokurorisë përkatëse do të konsiderohen si magjistratë të emëruar në nivelin përkatës të kësaj Gjykate dhe Prokurorie, me kushtin që të plotësojnë kriteret e sigurisë të vendosura në ligjin e posaçëm, duke përfshirë dhe heqjen dorë nga e drejta e privatësisë dhe e telekomunikimit dhe llogaritë bankare, firmosur nga kandidati dhe anëtarët e familjes së tij/saj.

Magjistratët e tjerë të cilët ushtrojnë funksionin e magjistratit ose kryetarit të gjykatës me hyrjen në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në këtë funksion sipas mandatit të përcaktuar në këtë ligj, edhe në rast se nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj, përveçse kur ka arsye për ndërprerjen e mandatit të tyre në kuptim të nenit për mbarimin e mandatit ose si rezultat i procesit të verifikimit të figurës dhe pasurisë së tyre (vetting), në përputhje me këtë ligj.

Ndihmësit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji mund të marrin statusin e magjistratit në rast se kalojnë me sukses procesin e verifikimit të figurës dhe pasurisë së tyre si dhe konkursin e pranimit të zhvilluar në Shkollën e Magjistraturës. Në këtë rast, atyre u lind e drejta për të ndjekur studime 10 mujore në vitin e parë të programit teorikë pranë Shkollës së Magjistraturës dhe për të ndjekur praktikën në gjykata të ndryshme në vitin e dytë. Në përmbyllje të vitit të dytë, ndihmësit ligjor marrin pjesë në provimin përfundimtar dhe renditen sipas rezultateve të këtij provimi dhe rezultateve të vetting. Mbas kësaj renditje, ata kanë të drejtën të emërohen si magjistrat në zbatim të këtij ligji.

Ndaj magjistratëve të cilët janë në pozicione të komanduara në strukturat e tjera në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji. Në zbatim të këtij ligji, përvoja profesionale në një pozicion të komanduar, konsiderohet përvojë profesionale si magjistrat. Inspektorët dhe Krye Inspektori në detyrë, të cilët ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ata i nënshtrohen procesit të vetting në përputhje me këtë ligj.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë përkatësisht Këshilli i Lartë Gjyqësor, përfundon vlerësimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit për periudhën 2007 – 2009, bazuar në rregullat ekzistuese para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshillat menjëherë me krijimin e tyre fillojnë me vlerësimin profesional të gjithë magjistratëve për periudhën e vlerësimit 2010 – 2013. Rregullat që gjenden në këtë ligj zbatohen për vlerësimin e kësaj periudhe. Menjëherë me krijimin e Komisionit të pavarur të kualifikimit dhe Dhomës së specialuar të kualifikimit, Këshillat duhet të mbështesin këto organe për kryerjen e vlerësimit të aftësive. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme do të vlerësohen për periudhën

2014 – 2015, ndërsa të gjithë magjistratët e tjerë do të jetë për periudhën 2014 – 2016 duke zbatuar parashikimet e këtij ligji.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dispozitat e mëposhtme shfuqizohen disa nene dhe kapituj të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ligjit nr. 9877, datë 18.02.1998 “Mbi organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, i ndryshuar, ligjit Nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit Nr 42/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e çështjeve administrative”, i ndryshuar. Ligjit nr. 8136, date 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen me përgjegjësitë kryesore për zbatimin e këtij projektligji janë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Gjithashtu, ky projektligj, në kapituj dhe pjesë të veçanta të tij parashikon detyra dhe përgjegjësi për institucione të tjera si Shkolla e Magjistraturës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, organet përfaqësuese të gjykatave (Këshillat gjyqësor, kryetari i gjykatës), etj.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Grupi i punës i ngarkuar për hartimin e këtij projektligji është ngritur në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, pjesë e Shtyllës për Pushtetin Gjyqësor. Në përbërje të këtij grupi pune kanë qenë ekspertë të nivelit të lartë, përfaqësues të Misionit Euralius IV, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Grupi i punës është asistuar nga Sekretariati Teknik, i përbërë nga ekspertë – juristë, këshilltar ligjor të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Misionit Euralius dhe juristë të fushës.

Në këtë projektligj u inkorporuan gjithashtu, dispozitat e projektligjit të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, për vlerësimin e gjyqtarëve.

Projektligji është hartuar gjatë periudhës Tetor 2015 – Qershor 2016 dhe ka qenë një dokument që është konsultuar intensivisht me përfaqësues të rrjetit të konsultimit Think Tank dhe në procese konsultimi i përbërë nga ekspertë të opozitës parlamentare, Ministrisë së Drejtësisë, Gjyqtarë, Prokurorë, Avokatë, Pedagogë, ekspertë të Prezencës së OSBE në Shqipëri, etj.

Gjithashtu, janë zhvilluar konsultime dhe takime të vazhdueshme me grupe të ndryshme interesi, përkatësisht me gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë, me inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me pedagogë të Shkollës së Magjistraturës dhe me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme. Këto konsultime janë bërë për kapituj të veçantë të projektligjit, sipas fushave përkatëse që ka prekur këto grupe interesi, përkatësisht për zhvillimin e karrierës së

magjistratëve, për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për dispozitat përfundimtare dhe tranzitore.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE